

Karta e Apostollit Pavël mbë Filipianëtë.

Krye 1.

1 Pavli edhe Timotheu, shërbëtorë të Jisu
2 Krishtit, mbë gjithë shënjtorëtë mbë Jisu
3 Krishtinë, që janë ndë Filippë, bashkë me
4 episkopët' e me dhjakëritë; Hir *qoftë* mbë ju
5 edhe paqtim prej Perëndisë, Atit t' ënë, edhe
6 prej Zotit Jisu Krisht.
7 I falem ndersë Perëndisë t'im sa herë u kuj-
8 tonj juve, (Sepse gjithënjë mbë çdo të-luturë
9 lutem me gëzim për gjithë ju,) Për pjesënë
10 t'uaj që *kini* ndë ungjillit që prej së-parësë
11 ditë e gjer ndashti; Sepse më është mbushurë
12 mëndja për këtë, se ay që nisi të *bënjë* pu-
13 në të-mirë ndër ju, dot'a mbaronjë gjer mbë
14 ditët të Jisu Krishtit. Sikundrë është' e-drejtë
15 tek unë të kem ndër mëntit këtë për gjithë
16 ju, sepse u kam juve ndë zëmëret' t' *ime*, se
17 edhe ndë të-lidhurat të mia, edhe ndë të-
18 mbrojturit me fjalë, edhe ndë të-vërtetuarët
19 të ungjillit ju të-gjithë keni qënë pjesëtarë
20 bashkë me mua ndë hirt. Sepse dëshmintari
im është Perëndia, se kam shumë mall për
gjithë ju me dashuri Jisu Krishti. Edhe për
këtë falem, që të tepëronjë dashuria juaj edhe

shum' e më shumë ndë të-njohur' e ndë çdo
10 të-kupëtuarë, Që të çquani ato që ndanjën
njëra prej tjetrësë, edhe të jeni zëmërë-kthje-
llëtë e të-papenguarë gjer mbë ditët të Krish-
11 tit, Plot me pemë drejtërie, të-cilatë janë me
anë të Jisu Krishtit, për lavdi e për lëvdim
të Perëndisë.
12 Edhe dua t'a dini, o vëllezër, se sa më
ngjanë mua ndihmë më tepërë për mbrothë-
13 sin' e ungjillit; Kaqë sa të-lidhurat' e mia për
Krishtinë ubënë të-çfaqura mbë gjithë gjy-
14 katën' e mbë gjithë të-tjerëtë; Edhe më të-shu-
mët' e vëllezërvet mbë Zonë, dyke marrë zë-
mërë nga të-lidhurat' e mia, më tepërë kuxo-
15 njënë pa frikë të flasënë fjalënë. Ca me të-
vërtetë nga cmiri e nga *dashuria për qarta*
e lëçisnjënë Krishtinë, po ca edhe nga dë-
16 shir' e-mirë. Ata e lëçisnjënë Krishtinë nga
cmiri, jo me zëmërë të-kthjellëtë, dyke pan-
dehurë se shtonjënë shtrëngime mbë të-lidhu-
17 rat të mia; Po këta nga dashuria, sepse dinë,
18 se jam vënë për të mbrojturë ungjillinë. Ç' del
pra? veç se me çdo farë mënyre, me shkak,
ose me të-vërtetë, Krishti lëçitetë, edhe për
19 këtë gëzohem, edhe dotë gëzohem. Sepse
e di, se këjo dotë më dalë për shpëtim, me
anë të të-luturit t' uaj, edhe me anë të ndih-
20 mës' së Frymës' së Jisu Krishtit, Pas të-pri-
turit pa durim edhe pas shpresësë s'ime, se
nukë dotë turpëronem as mbë ndonjë *gjë*, po

- me çdo kuxim, si gjithënjë, kështu edhe ndashti dotë madhëronetë Krishti ndë trup t' im, ose me anë jete, ose me anë vdekjeje.
- 21 Sepse tek unë të-rrrojturitë *është* Krishti, edhe të-vdekuritë, fitim.
- 22 Po ndë qoftë se të-rrrojturitë ndë misht t'im është që të sjellë pemë puna ime, atëhere
- 23 ç' të sgjeth nukë di: Sepse shtrëngonem prej të djave; sepse *nga njëra anë* kam dëshërim të ikënj e të jem bashkë me Krishtinë;
- 24 sepse *kështu është* shumë më mirë: Po *nga ana tjetërë* të-mbeturitë t' im ndë misht është
- 25 më të-nevojshim për ju. Edhe këtë me siguri e di se dotë mbetem edhe dotë qëndronj bashkë me gjithë ju, për mbarësinë t' uaj mbë
- 26 besët e për gëzimnë t' uaj; Që të tepëronjë me anë t' ime të-mburruritë t' uaj mbë Jisu Krishtinë, me të-ardhuritë t' im përsëri ndër
- 27 ju. Vetëmë të shkoni jetënë sikundrë vëjen mbë ungjillin' e Krishtit, që të dëgjonj për ju, ose kur të vinj e t'u shoh juve, ose përsë-largu kur s' jam aty, se qëndroni mbë një frymë, dyke përpjekurë me një shpirt përsë-bashkëti për besën' e ungjillit; E dyke mos
- 28 utrëmburë as mbë gjë nga ata që rrinë kundrë; e-cila gjë mbë ata dotë jetë dëftesë humbjeje, po mbë ju shpëtimi, edhe këjo nga
- 29 Perëndia. Sepse mbë ju është falurë për punë të Krishtit, jo vetëmë t' i besoni ati, po
- 30 edhe të pësoni për atë; Dyke pasurë gjithatë

luftë që patë mbë mua, edhe ndashti dëgjoni *se është* mbë mua.

Krye 2.

- 1 Ndë ka pra ndonjë ngushullim mbë Krishtinë, a ndonjë të-ngushulluarë dashurie, a ndonjë shoqëri Frymë, a zëmërë-dhëmbje e
- 2 përdëllime, Bëni të-plotë gëzimnë t' im me të-qënë mbë gjithatë mëndje, dyke pasurë gjithatë dashuri, dyke qënë një shpirt i-bash-
- 3 këtë e me një mëndje. Mos *punoni* asgjë prej cmiri a prej mëndjeje së-kotë, po me përunjtje mëndjeje, dyke numëruarë sicili tjetërinë
- 4 më të-lartë se vetëhen' e ti. Mos mendohi gjithë-sicili për të tiatë, po gjithë-sicili edhe për punët' e të tjerëvet.
- 5 Edhe letë jetë mbë ju gjithajo mëndje që
- 6 ishte edhe mbë Jisu Krishtinë; I-cili, dyke qënë ndë formët të Perëndisë, nuk' e numëroj për rrëmbim të-qënuritë si-një-një me
- 7 Perëndinë; Po sbrazi vetëhen' e ti, edhe mori formë shërbëtori, e ubë posi njerëzitë mbë
- 8 të-përgjajturë; Edhe dyke ugjëndurë ndë fytyrët posi njeri, e përunji vetëhen' e ti, e ubë i-bindurë gjer mbë vdekje, edhe vdekje kryqi.
- 9 Përandaj edhe Perëndia e lartoj fort tepërë, edhe i fali ati *një* emërë që *është* përmbi çdo
- 10 emërë; Që mbë emërit të Jisujt të unjetë çdo gju i atyreve që janë ndë qiejt e mbi dhet
- 11 e ndënë dhet, Edhe çdo gjuhë të rrëfenjë se

- Jisu Krishti është Zot, për lavdi të Perëndisë
- 12 Atë. Përandaj, o të-dashurit' e mi, sikundrë keni qënë të-bindurë përherë, jo sikundrë keni qënë vetëmë kur jam ndër ju, po ndashti shumë më tepërë që nukë jam ndër ju, punoni për shpëtimn' e vetëhesë s' uaj me frikë
- 13 e me të-dridhurë; Sepse Perëndia është ay që vepëron ndër ju edhe të-dashurit' edhe
- 14 të-vepëruarëtë, pas pëlqimit të ti. Bëni të-
- 15 gjitha pa murmuri e pa kundrështime, Që të jeni faqebardhë e të-tërë, bij Perëndie pa të-metë, ndë mest të një kombi dredharak e të-shtrëmbërë, ndër mest të të-cilëvet
- 16 ndritni posi dritarë ndë botët, Dyke mbajturë fjalën' e jetësë, për të-mburruritë t' im ndë ditët të Krishtit, se nukë brodha mbë
- 17 kot, as mbë kot nuk' umunduashë. Po edhe ndë qoftë se bënem të-çpërkaturë përmbi kurbant e përmbi shërbesët të-besësë s' uaj, gëzonem e gasmonem bashkë me gjithë ju;
- 18 Gjithashtu edhe ju gëzohi e gasmohi bashkë me mua.
- 19 Edhe shprenj mbë Zotinë Jisu, Timothënë t'a dërgonj për-së-çpejti ndër ju, që të më ngushllonetë shpirti edhe mua, kur të marr vesh punëratë t' uaj. Sepse s'kam asndonjë
- 20 *tytërë* që t'a ketë shpirtinë si-një-një *me t' iminë*, i-cili me zëmërë të-kthjellëtë të kuj-
- 21 desetë për punëratë t' uaj. Sepse të-gjithë kërkonjënenë *enteresat'* e tyre, jo ato të Jisu Krish-

- 22 tit. Edhe e dini provimin' e ati, se, posi bir me t' anë, punoj bashkë me mua për ungji-
- 23 llinë. Këtë pra shprenj t'a dërgonj sa-kaqëherash, posa që të marr vesh si dotë venë
- 24 punërat' e mia, Edhe kam besë mbë Zotinë se edhe vetë për-së-çpejti dotë vinj.
- 25 Po umenduashë se është e-nevojshime të dërgonj ndër ju Epafrodhitnë, vëllanë edhe bashkëpunëtorinë edhe bashkëushtëtorinë t' im, që udërgua nga ju, edhe më shërbeu
- 26 ndë nevojët; Sepse kishte shumë mall për ju të-gjithë, edhe i vinte keq, sepse dëgjuatë
- 27 se qe sëmurë. Edhe vërtet qe sëmurë afërë për vdekje; po Perëndia e përdëlleu; edhe jo vetëm' atë, po edhe mua, që të mos kem
- 28 hidhërim mbi hidhërim. Përandaj u'a dërgova atë juve më me nxitim, që të gëzohi, kur t'a shihni atë përsëri, edhe unë të kem më pak
- 29 hidhërim. Prit-e-ni atë mbë Zotinë më çdo
- 30 gëzim, edhe të-këtilillëtë t' i keni mbë nder; Sepse për punën' e Krishtit uafërua gjer mbë vdekje, dyke vënë ndënë rrëzik jetën' e ti, që të mbushnjë të-shterët' e shërbesësë s' uaj mbë mua.

Krye 3.

- 1 Mbë ndë funt, o vëllezërit' e mi, gëzohuni mbë Zotinë. T'u shkruanj juve gjithato *gjërëra*, për mua s' është pun' e-rëndë, po për ju është siguri.

- 2 Ruhi nga qëntë, ruhi nga punëtorët' e-liq;
 3 ruhi nga të-prerëtë; Sepse rrethpresja jemi
 neve që adhurojmë Perëndinë me frymë, edhe
 që mburremi mbë Jisu Krishtinë, edhe nukë
 4 kemi shpresë ndë misht; Ndonëse edhe unë
 kam besim ndë misht. Ndë pandeh ndonjë
 tjetërë, se ka besim ndë misht, unë *gjan të*
 5 *kem* më shumë; Rrethprerë tetë ditsh, prej
 kombit të Israilit, prej farës' së Veniaminit,
 6 Evre prej Evrenjsh, pas nomit Farise, Nga
 përvëlim' i zëmërsë ndjekës i kishësë, nga
 7 drejtëria që është pas nomit faqe-bardhë. Po
 ato që më ishinë fitim, këto i numërova
 8 për Krishtinë dëm. Po, me të-vërtetë kujtonj
 të-gjitha se janë dëm për të-çquarët' e të njo-
 hurit të Jisu Krishtit, Zotit t'im; për të-cilinë
 udëmëtova të-gjitha, edhe i numëronj se janë
 9 plehë, që të fitonj Krishtinë, Edhe të gjëndem
 me atë, dyke pasurë jo drejtërinë t'ime që
 është prej nomit, po atë që është me anë
 të besësë mbë Krishtinë, drejtërinë që është
 10 prej Perëndisë mbi besët; Që të njoh atë,
 edhe fuqin' e të-ngjallurit t'ati, edhe shoqë-
 rin' e të-hequravet t'ati, dyke bërë vetëhenë
 11 mbë një formë me vdekjen' e ati; Mbase
kështu i arrinj të-ngjallurit prej së-vdekurish.
 12 Jo se unë ndashti e kam marrë bravurënë,
 a se jam bërë i-sosurë, po e ndjek prapa,
 mbase e arrinj, për të-cilënë gjë edhe uzushë
 13 prej Jisu Krishtit. O vëllezër, unë s'e numë-

- 14 ronj vetëhenë t'ime se e kam marr' atë; Po
 një *punë bënj*, dyke harruarë ato që *shkuanë*
 prapa, edhe dyke shtriturë mb' ato që *kam*
 përpara, sulem drejt shënjësë mbi bravurën'
 e të-thërriturit të Perëndisë mbë Jisu Krish-
 tinë prej së-larti.
 15 Sa jemi të-sosurë pra, këtë letë kemi
 ndër mëntt; po ndë mendoneni për ndonjë
gjë ndryshe, edhe këtë dot' u'a sbulonjë
 16 juve Perëndia. Po mbë atë që arritmë, pas
 gjithasaj rregulle letë ecëjmë, gjithatë *gjë* letë
 kemi ndër mëntt.
 17 O vëllezër, bëhi bashkë-shëmbëllenjës të
 mi, edhe vini re ata që ecënjënë kështu, sikun-
 18 drë na keni neve shëmbëllesë. Sepse shumë
 ecënjënë, për të-cilëtë u thoshnjam juve shu-
 më herë, edhe ndashti dyke qarë po u them,
 19 se *ata janë* armiqt' e kryqit të Kristit; E pas-
 tajmja e të-cilëvet është humbje, edhe Pe-
 rëndia i të-cilëvet *është* barku, edhe lavdia
 e *atyre është* ndë turpërit t'atyre, të-cilëtë
 20 kanë ndër mëntt punërat' e dheut. Sepse,
 të-rrrojturitë t'ënë *është* ndë qiejt, që ku edhe
 21 presimë Shpëtimtarinë, Zotnë Jisu Krisht; I-
 cili dotë ndërronjë trupin' e të-përunjurit t'
 ënë, që të bënetë mbë një formë ine trupin'
 e lavdis' s'ati, pas vepërimit me të-cilinë *ay*
 munt edhe të vërë të-gjitha ndënë vetëhen
 e ti.

Krye 4.

- 1 Përandaj, o vëllezërit' e mi të-dashurë e të-mallënjyerë, gëzimi edhe kurora ime, kë-shtu qëndroni mbë Zotinë, o të-dashurë.
- 2 I lutem Evodhisë, i lutem edhe Sintikësë,
3 gjithatë mëndje të kenë mbë Zotinë. Edhe të lutem edhe ty, o shoku i-thjeshtë, ndih-u atyreve, të-cilatë umunduanë bashkë me mua ndë ungjillt, bashkë edhe me Klimentinë edhe me të-tjerëtë bashkëpunëtore të mi, emërat' e të-cilëvet janë ndë vivlët të jetësë.
- 4 Gëzohi përherë mbë Zotinë; përsëri dotë
5 them, Gëzohi. Butësira juaj letë njihetë mbë
6 gjithë njerëzitë. Zoti është afërë. Mos kini kujdes për asgjë; po mbë çdo gjë letë njihenë të-kërkuaratë t' uaj te Perëndia me të-falurë ndersë me anë të të-falurit e të të-luturit. Edhe paqtimi i Perëndisë që kapërxen çdo mëndje dotë ruanjë zëmëratë t' uaj edhe mendimetë t' uaj me anë të Jisu Krishtit.
- 8 Përandaj, o vëllezër, sa janë të vërteta, sa janë të-hieshime, sa janë të-drejta, sa janë të-qëruara, sa janë të-dashura, sa janë të-dëgjuara me nder të-mirë, ndë ka ndonjë mirësi, edhe ndë ka ndonjë lëvdim, këto mendoni. Ato që edhe nxutë, edhe muartë, edhe dëgjuatë, edhe patë tek unë, këto punoni; edhe Perëndia i paqtimit dotë jetë bashkë me ju.
- 10 Edhe ugëzova mbë Zotinë shumë, se nda-

- shti përsëri e rrëfytë të-lulëzuarë kujdesnë që kini për mua; për të-cilinë edhe kujdese-
11 shitë, po s'kishitë kohë të-pëlqyerë. Nuk'e them këtë se s'kam të-nevojshimetë; sepse unë jam mësuarë të jem i-kënaqurë me ato që kam.
- 12 Di të përunjem, di edhe të rronj me të-tepëra; mbë çdo vënt e mbë të-gjitha jam mësuarë edhe të nginjem edhe të kem uri, edhe të rronj me të-tepëra edhe të shkonj
13 me skamje. Të gjitha munt t'i bënj me anë të Krishtit që më ep fuqi.
- 14 Po bëtë mirë që m'ubëtë shokë ndë shrë-
15 gimt t'im. Edhe ju, o Filipianë, e dini, se ndë të-nisurit të ungjillit, kur dolla nga Maqedhonia, asndonjë kishë nukë m'ubë shoqe
16 për dhënëje e për marrje veç ju vetëmë; Sepse edhe ndë Thesalonikë një herë edhe dy herë
17 ndë nevojët më dërguatë ndihmë: Jo se kërkonj dhuratë; po kërkonj pemënë që shumonetë për llogari t' uaj. Po të-gjitha i kam, edhe më tepëronjënë; jam i mbushurë, se prita prej Epafrodhitit ato që më dërguatë ju, ere të-mire, kurban të-priturë, të-pëlqyerë
19 te Perëndia. Edhe Perëndia im ka për të mbushurë gjithë nevojën t' uaj pas pasjes' së ti ndë lavdi, me anë të Jisu Krishtit.
- 20 Edhe mbë Perëndinë edhe Atinë t'ënë goftë lavdia ndë jetët të jetëvet. Amin.
- 21 Epni të-fala me shëndet çdo shënji mbë Jisu Krishtinë; u falenë me shëndet vëllezë-

- 22 ritë që janë bashkë me mua U falenë juve me shëndet gjithë shënjtorëtë, po më fort ata që janë nga shtëpia e Qesarit.
- 23 Hir' i Zotit t'ënë Jisu Krisht *qoftë* bashkë me gjithë ju. Amin.
-